

RAPORTI VJETOR



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJËVE PËR TË DREJTAT E NËRIUT
INICIATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA



2022



PËRMBAJTJA

01

**PARATHËNIE
NGA DREJTORJA
E YIHR KS**

02

**ARRITJET
NË 2022**

03

**KUSH JEMI NE /
MISIONI /
VIZIONI**

04

**EKIPI
YIHR KS**

05

**YIHR KS &
MIRËQENIA**

06

**NGJARJET
E VITIT 2022**

07

**PROGRAMET
TONA**

08

**PROGRAMI 1:
BALLAFAQIMI
ME TË KALUARËN**

09

**PROGRAMI 2:
TË DREJTAT E
NJERIUT DHE
SUNDIMI I LIGJIT**

10

**PROGRAMI 3:
FUQIZIMI I
RINISË**

11

**JAVA E TË
DREJTAVE
TË NJERIUT**

12

PROTESTAT

13

**AKSIONET
RRUGORE**

14

**AKTIVITETET
E TJERA NË
2022**

Një tjetër vit sfidues, por aktiv dhe fuqizues për YIHR KS!

Aktivizmi, solidariteti dhe pasioni për ndryshim kurrë nuk kanë qenë më të fortë. Më shumë se 2,400 të rinj e të reja kanë qenë përfitues direkt të 151 aktiviteteve tona të ndryshme. Jemi krenarë që viti 2022 ka shënuar një moment historik në kontributin tonë në proceset e ballafaqimit me të kaluarën dhe ndërtimit të paqes, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Femicidi, dhuna seksuale dhe homofobia institucionale, fatkeqësisht, kanë qenë shumë të përhapura gjatë gjithë vitit. Megjithatë, YIHR KS i është bashkuar çdo proteste që kërkon mbrojtjen e grave dhe vajzave dhe është zotuar të mbrojë dhe avokojë për të drejtat e njeriut në çdo rast. Njëherit, ne kemi monitoruar gjuhën e urrejtjes në kuvend dhe në media dhe kemi qenë konsistent në mbështetjen dhe avokimin tonë për përfshirjen e martesave mes personave të seksit të njejtë në draft Kodin Civil. Ne besojmë në ndryshime strukturale, andaj, gjatë aksioneve tona rrugore, protestave dhe aktiviteteve të tjera të avokimit mesazhet tona kryesore janë fokusuar në kërkimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënjes nga institucionet.

Për më tepër, pajtimi ndëretnik dhe paqja mbeten prioritetet kyçe në punën tonë. Muzeu i Fëmijëve të Luftës është në fazat përfundimtare para lansimit në vitin 2023. Kjo është një përpjekje e jashtëzakonshme për të përmirësuar kujtesën kolektive për luftën e fundit në Kosovë si një mënyrë për t'u ballafaquar me të kaluarën si dhe për të zhvilluar një qasje kritike ndaj narrativave përçarëse nacionaliste përmes hulumtimit dhe dokumentimit të përvojave dhe tregimeve nga koha e luftës. Jemi krenarë dhe të lumtur që kemi dhënë një kontribut thelbësor në avancimin e dialogut mes njerëzve, duke krijuar hapësira të sigurta për bashkëpunim ndëretnik ndërmjet të rinjve/rejave të komuniteteve të ndryshme dhe duke i fuqizuar ata/ato që të jenë kampionët/et e ardhshëm/me të ndryshimit në trajtimin e procesit të ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Duke ditur rëndësinë jetike të aktivizmit në luftën për të drejtat e njeriut kemi ndërtuar platforma të reja për promovimin dhe mbështetjen e aktivizmit. Këtë vit inaguruam hapësirën tonë të aktivizmit, një hapësirë e sigurtë në shërbim të të gjithë aktivistëve/eve dhe për herë të parë ndamë çmimin Aktivisti/ja i/e Vitit për të Drejtat e Njeriut, i cili shërben si një platformë e mirënjohjes për punën e palodhshme të aktivistëve/eve dhe njëkohësisht promovon aktivizmin për të drejtat e njeriut. Për më tepër, publikuam raportin tonë të 3-të të përbashkët vjetor të OShC-ve për të drejtat e njeriut, i vetmi publikim i kësaj natyre që sjell rreth 40 OShC në një iniciativë të përbashkët për të analizuar situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe jep rekomandime konkrete për institucionet për zbatimin e të drejtave të njeriut.

Ky vit ishte sfidues, por edhe fuqizues. Ne do të vazhdojmë me aktivizmin tonë për drejtësi, barazi, paqe dhe liri në vitin 2023. Shpresojmë të kemi mbështetjen tuaj të vazhdueshme!

Përzemërsisht,
Marigona Shabiu
Drejtoresh Ekzekutive

ARRITJET NË 2022



ARRITJET NË 2022

2,444

**Përfitues
direkt**

151

Aktivitete

9

**MoUs me
OShC dhe
Institucione**

10

**Aksione
rrugore**

8

PROTESTA

ARRITJET NË BAZË TË PROGRAMEVE

PROGRAMI BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN

1

**Program i Praktikës
për Paqe**

15 praktikantë/e

3

**World Cafes/
"Kafenetë e Botës"**

100 pjesëmarrës/e

1

**Konferencë mbi "Përk-
ujtimet e luftërave të
viteve 1990 në 2021"**

2

**Programe të
Shkëmbimit të
të rinjëve**

54 pjesëmarrës/e

1

**Trajnim mbi rritjen e
kapaciteteve për
përfaqësues nga
OShC**

19 pjesëmarrës/e

1

**MoU me
Bibliotekën
Kombëtare**

6

Aksione Rrugore

4

**Sesione Informuese
mbi 'Parimet e
Ballafaqimit me të
Kaluarën'**

PROGRAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E LIGJIT

4

Memorandume të
Bashkëpunimit

1

Lansim i Raportit
të përbashkët të
OShC-ve për të
Drejtat e Njeriut

55 pjesëmarrës/e

3

Takime konsultative
për Raportin e
përbashkët të
OShC për të
Drejtat e Njeriut

30 pjesëmarrës/e

1

Punëtori për ngritje
të kapaciteteve

56 pjesëmarrës/e

4

Gjykime të Simuluara

120 pjesëmarrës/e

1

Garë Artistike

3 Fitues/e

2

Living Libraries/
“Biblioteka të Gjalla”

89 pjesëmarrës/e

2

Aksione Rrugore

4

Murale të Drejtësisë

27

Ligjërata për Drejtësi

450 pjesëmarrës/e

1

Ditë e Gjykatës
së Hapur

22 pjesëmarrës/e

1

Shkollë Alternative
për të Drejtat
e Njeriut

22 pjesëmarrës/e

2

Programe të
Monitorimit të
Seancave Gjyqësore

96 pjesëmarrës/e

15

Raportime në
Platformën
E Drejta Jem

2

Programe të Praktikës
në Gjykata

60 pjesëmarrës/e

PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E RINISË

3

Living Libraries/
"Librari të Gjalla"

58 pjesëmarrës/e

25

Takime Bilaterale

4

Punëtori me Rrethin
e Kohezionit

100 pjesëmarrës/e

1

Kamp Rinor i Paqes

23 pjesëmarrës/e

1

Manual mbi Edukimin
Qytetar për Paqe

2

Punëtori për Storytelling

42 pjesëmarrës/e

4

Aksione Rrugore

1

Program i Praktikës
për komunitetet
jo-shumicë

1 praktikant
nga komuniteti
Rom

4

MoU me OShC



KUSH JEMI NE / MISIONI / VIZIONI

03



KUSH JEMI NE

Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) fillimisht u themelua si organizatë jo qeveritare regjionale në vitin 2003, e më pas u transformua në rrjetin regjional të YIHR në Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Për më shumë se 19 vite, Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosova (YIHR KS) (Youth Initiative for Human Rights - Kosova) ka punuar me sukses në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Më specifikisht, YIHR KS fokusohet në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e të rinjëve në nivel lokal dhe regjional.

MISIONI

YIHR KS promovon, mbron dhe avokon për të drejtat e njeriut, proceset e ballafaqimit me të kaluarën, sundimin e ligjit dhe vlerat qytetare si parime fundamentale të një shoqërie të lirë, të përgjegjshme dhe progresive.

VIZIONI

Një shoqëri e lirë, e barabartë dhe e drejtë ku të gjithë njerëzit mund të realizojnë potencialin e tyre të plotë.

EKIPI YIHR KS

04



EKIPI YIHR KS



MARIGONA SHABIU

Drejtoresh e Ekzekutive



ENIS SELIMI

Menaxher i Financave
dhe Administratës



RINA KADIRI

Menaxhere e Programit
dhe Operimit



BJESHKA GURI

Kordinatore e Programit



BLENDE PIRA

Hulumtuese Ligjore
dhe Kordinatore e
Programit



FJOLLA ZEJNULLAHU

Kordinatore e
Projekteve dhe
Zhvillimit



FIONA HAXHIISLAMI

Kordinatore e Projektit
dhe Komunikimeve



ERONA HAJDARI

Zyrtare e Administratës
dhe Burimeve Njerëzore



ILIR VITIJA

Kordinator i Projektit



ERA CINA

Asistente e Programit



URESA AHMETI

Asistente e Programit
dhe Komunikimeve



RITA TËRSTENA

Dizajnere Grafike




HANA BERISHA

Asistente e Programit



ANIDA GJURGJIALI

Asistente e Programit
dhe Monitorimit



ART VULA

Asistent i Programit




SUZANA MARIĆ

Asistente e Programit



Isabel Conforti

Fulbright Fellow



Dimitrije Obrenovic

Fellow i Paqes

YIHR KS & MIRËQENIA

05



YIHR KS & Wellbeing

Një fjalë nga Burimet Njerëzore

Njëra nga prioritetet e menaxhmentit të YIHR KS gjatë vitit 2022 ka qenë promovimi dhe vetëdijësimi mbi shëndetin mendor dhe mirëqenien e ekipit. YIHR KS është përkushtuar për t'i bërë anëtarët e ekipit të ndihen të vlerësuar, të mbështetur dhe të sigurtë.

YIHR KS po punon vazhdimisht për të zhvilluar politika dhe praktika që mbështesin mirëqenien dhe shëndetin mendor të ekipit dhe njëkohësisht mbështet aktivitetet sociale për të krijuar një marrëdhënie më të ngushtë dhe miqësore ndërmjet ekipit.

Viti 2022 ka qenë një vit i suksesshëm për sa i përket mirëqenies dhe promovimit të praktikave të shëndetshme të punës. Synimi jonë është që në vitin 2023 të vazhdojmë dhe të forcojmë edhe më shumë punën tonë në këtë drejtim!

Përzemërsisht,

Erona Hajdari
Zyrtare e Administratës
dhe Burimeve Njerëzore

NGJARJET E VITIT 2022

06



Akreditimi

Gjatë këtij viti, Programi i të Drejtave të Njeriut u akreditua nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për dy vite. Programi përmbanë informacione praktike mbi të drejtat e njeriut, kornizën ligjore dhe institucionet e drejtësisë, sikur gjykatat, prokuroritë, Institucioni i Avokatit të Popullit, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Odën e Avokatëve të Kosovës, etj. Programi aktualisht po përdoret si pjesë e programit arsimor të YIHR KS për të drejtat e njeriut me studentë/e të shkollave të mesme dhe universiteteve nga rajone të ndryshme të Kosovës.



Publikimi i qasshëm në këtë vegëz:

<https://bit.ly/3RTLJ7y>

Publikimi i “Narrativat e Përbashkëta: Përkrahja e pajtimit përmes tejkalimit të hendeqeve të narrativave ndarëse”


Rrjeti Regjional Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut ka publikuar “Narrativat e Përbashkëta: Përkrahja e pajtimit përmes tejkalimit të hendeqeve të narrativave ndarëse”. Në shtëpinë botuese në Zagreb, më 9 qershor, Nikola Kandic, Viktorija Stankovic, Vuk Vujisic, Engjell Hamiti dhe Maja Žilic prezantuan “Narrativat e Përbashkëta”, për çka punuan me të rinj nga i gjithë regjioni. Publikimi i fundit në kuadër të programit “E kaluara vazhdon”, përfshiu të rinj në procesin e dialogut për të parandaluar përsëritjen e dhunës që ka ndodhur në vitet e 90-ta në Ish-Jugosllavi.

Forumi Gratë, Paqja dhe Siguria

Më 22 tetor, YIHR KS bashkëpunoi me Zyrën e Presidentes të Kosovës për të realizuar panelin “Perspektivat e të rinjve/rejave dhe roli i tyre i fuqishëm në proceset e paqes dhe ballafaqimit me të kaluarën” në kuadër të Forumit “Gratë, Paqja dhe Siguria.”

Paneli u moderua nga Drejtoresha Ekzekutive e YIHR KS, Marigona Shabiu dhe u përbë nga këta folës: Albert Hani – Sekretar i Përgjithshëm, RYCO; Maliha Iqbal - Bursiste Studiuëse e IKEA-s dhe Shefe e Partneritetit, Mundësitë për të Rinjtë/Rejat; Chamithri Rambukwella – Diplomate, Sri Lanka; Daniel del Valle Blanco - Diplomati; Përfaqësues i Lartë për Rininë, Fondacioni Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut; Neha Swain - Fituese e Çmimit për Udhëheqësit e Rinj/Reja të Mbretëreshës Elizabeth dhe bashkëthemeluesja e OJQ-së Rubaroo.

Diskutimi u fokusua në atë se si duhet të krijohen hapësira dhe mundësi për të rinjtë/rejat me prejardhje të ndryshme si ‘ndërtuesit e tanishëm dhe të ardhshëm të paqes’ për të ndarë vizionin e tyre mbi paqen dhe sigurinë pasi që është jetike rritja e rolit të tyre në sfidimin jo vetëm fizik, por edhe strukturor dhe kulturor të dhunës në komunitetet e tyre.



Inagurimi i Hapësirës së Aktivizmit dhe Çmimi Aktivisti/ja i/e Vitit

Më 7 dhjetor, ditën e parë të Javës për të Drejta të Njeriut, YIHR KS inaguroi Hapësirën e re për Aktivistë/e. Hapësira e Aktivizmit është një vend i hapur dhe i sigurtë për të rinj/reja e paraparë të përdoret nga aktivistë/e dhe të rinj/reja nga të gjitha komunitetet.

Gjatë ceremonisë së hapjes, YIHR KS për herë të parë shpalli fituesin e çmimit Aktivisti/ja i/e Vitit për të Drejtat e Njeriut 2022. Juria e pavarur, pas shqyrtimit të të gjitha nominimeve, përzgjedhi si fitues Lend Mustafa për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të personave LGBTQIA+.



Rights Land Podcast

YIHR KS lansoi Rights Land Podcast për herë të parë në Edicionin e 9të të Javës për të Drejta të Njeriut.

Mund ta shikoni episodin e parë të Rights Land Podcast përmes kësaj vegëze:


<https://bit.ly/3Jy0VW1>

Rights Land Podcast shfaq dhe zbërthen pabarazitë e pushtetit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe njëkohësisht portretizon dhe avokon për një të ardhme të barabartë dhe të drejtë!

Kjo platformë u jep zë perspektivave të të rinjve/rejave dhe të grupeve të marginalizuara.

E keni pyetur ndonjëherë veten se çka bëjnë homofobët në pozicionet e tyre të pushtetit? A keni menduar ndonjëherë se është shqetësuese që shteti flet për sigurimin e të drejtave të njeriut për të gjithë, e në të vërtetë disa grupe njerëzish vuajnë?

Shikoni këtë episod për të dëgjuar Uresa Ahmetin duke diskutuar me Haveit, një kolektiv feminist, mbi dhunën me bazë gjinore, të drejtat LGBTQIA+ dhe si të parandaloni 'burn out' ose stërngarkimin në mënyrë që të jeni një aktivist i qëndrueshëm për të drejtat e njeriut.



Rights Land Podcast - Episode 1

2 views · Dec 9, 2022

0 DISLIKE SHARE CLIP SAVE ...



Raporti i tretë i përbashkët i OS-hC-ve për të Drejtat e Njeriut 2021

Në maj të vitit 2022, Rrjeti i të Drejtave të Njeriut publikoi Raportin e Tretë të Përbashkët të OS-hC-ve për të Drejtat e Njeriut 2021. Ky raport është pasqyrim i situatës të së drejtave të njeriut në Kosovë në vitin 2021. Rreth 37 OS-hC që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut kontribuan me rekomandimet e tyre në raport. Ky dokument përmban më shumë se 100 rekomandime specifike të cilat i janë adresuar institucioneve kompetente.

YIHR KS ka paraqitur ankesë në Odën e Avokatëve të Kosovës ndaj avokatit Tomë Gashi

YIHR KS ka paraqitur një ankesë në OAK (Oda e Avokatëve të Kosovës) në lidhje me një video që ka qarkulluar në rrjetet sociale, ku avokati Tomë Gashi shihet duke shkëlmuar paratë e një lypësi në sheshin kryesor të Prishtinës. OAK nuk e ka cilësuar YIHR KS si palë në procedurat ligjore, duke pasur parasysh se YIHR KS nuk ka asnjë interes ligjor në këtë çështje. Më pas, rasti është adresuar nga OAK-ja, ku z. Gashi është gjobitur me 2500 euro për sjelljen e tij joetike.



YIHR KS ka iniciuar procedurë ligjore për një kontest civil kundër Këshillit të Kosovës për Media të Shkruara.

Më 11 prill 2022 YIHR KS bëri dy kërkesa të veçanta dhe formale për heqjen e një videoje që u shpërnda gjerësisht nëpër media të ndryshme të shkruara në Kosovë. Kërkesat bazoheshin në nocionin se videoja përmbante gjuhë që në mënyrë të arsyeshme mund të interpretohej si gjuhë e urrejtjes ose gjuhë që është mungesë respekti ndaj komunitetit serb në Kosovë.

Këshilli i Kosovës për Media të Shkruara i refuzoi të dyja kërkesat. Më pas, më 10 maj 2022 YIHR KS ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në kuadër të Departamentit për Konteste Administrative. Megjithatë, gjykata e ka ridrejtuar padinë në departamentin e mosmarrëveshjeve civile, pasi Departamenti për Konteste Administrative e ka konsideruar veten si pa juridiksion në këtë çështje.

PROGRAMET TONA

07



PROGRAMI PËR BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN

YIHR KS vazhdon të kontribuojë duke krijuar dhe mbajtur platforma për ballafaqim me të kaluarën si dhe iniciativa për ndërtimin e paqes në të gjithë rajonin. Ky program fokusohet në mbështjetjen e iniciativave dhe ndërgjegjësimin e njerëzve, veçanërisht të të rinjve/rejave, për të kaluarën me theks të veçantë në Kosovë dhe më gjerësisht në Ballkanin Perëndimor. Ne synojmë të ndërtojmë dhe ruajmë kujtesën kolektive dhe të kontribuojmë në proceset e ndërtimit të paqes.

PROGRAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E LIGJIT

YIHR KS mbetet një organizatë udhëheqëse në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Që nga viti 2004, YIHR KS ka punuar në monitorimin dhe raportimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe avokimin për zbatimin e ligjeve dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu, YIHR KS synon të vazhdojë të jetë një mbrojtës dhe promovues aktiv i të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në rajon.

PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E RINISË

YIHR KS beson në forcën e rinisë si qytetarë të përgjegjshëm dhe aktivë në ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe paqësore. Prandaj, fokusi kryesor i këtij programi është i dyfishtë. Së pari, është fuqizimi i të rinjve/rejave për t'u bërë pjesëmarrës/e aktivë/e në jetën shoqërore dhe politike në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe global nëpërmjet edukimit formal dhe joformal. Së dyti, është për të rritur kapacitetet e të rinjve/rejave në angazhimin, mbrojtjen dhe avokimin e të drejtave të njeriut për të gjithë dhe në angazhimin në proceset e ballafaqimit me të kaluarën.

PROGRAMI PËR BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN

08



PROGRAMI PËR BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN

PROJEKTI

DIALOGU I TË RINJVE/REJAVE KOSOVAR/E

Dialogu i të Rinjve/Rejave Kosovare/e është një projekt 72-mujor. Ky projekt ka për qëllim kryesor fuqizimin e të rinjve/rejave për t'u bërë pjesë aktive në ballafaqimin me të kaluarën dhe proceset e pajtimit në Kosovë duke inkurajuar komunikimin, ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, adresimin e interesave të përbashkëta, ndërtimin e besimit dhe promovimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe qëndrimeve pozitive.

Muzeu i Fëmijëve të Luftës

Ne kemi punuar për inagurimin e Muzeut tonë të Fëmijëve të Luftës në Kosovë në vitin 2023. Ishte një fazë përgatitore produktive. Takimet me palët e interesuara, kërkimi, zhvillimi i konceptit kuratorial ndër procese të tjera kyçe shënuan një vit shumë të suksesshëm në lidhje me hapjen e Muzeut tonë të Fëmijëve të Luftës.

Programi i Shkëmbimit të të Rinjve/Rejave

Gjatë prillit dhe shtatorit, dy (2) Programet e Shkëmbimit të të Rinjve u ofruan 54 të rinjve/rejave mundësinë për të mësuar më shumë mbi ballafaqimin me të kaluarën, paqen dhe konfliktin, gjuhën e urrejtjes, stereotipet dhe paragjykimet dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi me një udhëheqës/e profesionist/e. Përgjatë një jave aktiviteteve interaktive, vizitave përkujtimore dhe punës në grup me mentorët tanë në prodhimin e videove, fotografisë, tregimit dhe teatrit, pjesëmarrësit u angazhuan të zhvillojnë empati, të kërkojnë të vërtetën dhe të përdorin format e artit si një mjet për të kundërshtuar së bashku narrativat nacionaliste që ekzistojnë në shoqëritë tona, dhe në të njëjtën kohë të promovojnë pajtimin mes tyre dhe më gjerë. Puna ekipore nisi shumë marrëdhënie pozitive mes pjesëmarrësve dhe dha produkt të projekteve të përbashkëta artistike të cilat përçuan mesazhe domethënëse. Për shumë prej tyre, kjo ishte hera e parë që po punonin së bashku me një të ri/re nga komuniteti tjetër etnik.

Lajmi i mirë është se për edicionin e Programit të 7-të të Shkëmbimit të të Rinjve, pati edhe tre aktivitete të tjera vijuese. Pjesëmarrësit u takuan sërish pas fazës së parë të programit njëjavor.

Në fazën e dytë Kampionët tanë të Paqes patën një udhëtim ditor në qytetet multietnike të Kosovës si Mitrovica e Jugut dhe Mitrovica e Veriut dhe Graçanica. Në Mitrovicë, kaluam nëpër urë dhe ecëm deri te Monumenti i Minatorit. Gjatë kësaj kohe folëm së bashku për vendet e bashkëpunimit ndëretnik dhe vendet e unitetit etnik. Ne vizituam Graçanicën si destinacionin tonë të radhës gjatë udhëtimit tonë ditor. Ne u mirëpritëm nga Young Active Gracanica dhe dëgjuam më shumë për iniciativat e tyre lokale dhe aktivizmin qytetar. Në fazën e tretë, Kampionët tanë të Paqes u mbledhën për trajnimin tonë për Shkrimin e Projekteve për të mësuar më shumë mbi teknikat e shkrimit të projektit, implementimin e projektit dhe përpilimin e buxhetit. Ata gjithashtu patën një mundësi të propozonin idetë e tyre për të aplikuar për grantet tona të projektit prej \$1000, pjesë e fazës sonë të katërt të projektit, duke trajtuar temat e paqes, konfliktit dhe pajtimit. Në fazën e katërt të YEP 7 pjesëmarrësit patën mundësinë të paraqesin projekt propozimet e tyre për të fituar grantet tona. Kjo iniciativë u konceptua për të fuqizuar të rinjtë/rejat dhe rolin e tyre në komunitetet e tyre.



‘World Café me Vendimmarrës’ në Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë

Aktiviteti World Café me vendimmarrës është mbajtur në Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë. Më shumë se 90 të rinj e të reja nga grupe të ndryshme etnike patën mundësinë të bisedojnë me vendimmarrës lokal dhe shtetëror, të diskutojnë ide dhe shqetësime dhe të shprehin nevojën e tyre si të rinj/reja për t’u bërë aleatë/e me vendimmarrësit në promovimin e mëtejshëm të ndërtimit të kapaciteteve për të rinj/reja.

Trajnim për Ngritjen e Kapaciteteve për Përfaqësuesit e OJQ-ve

Nëntëmbëdhjetë (19) përfaqësues të organizatave joqeveritare në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe pajtimit morrën pjesë në trajnimin tre ditor në ngritjen e kapaciteteve dhe aktivizmit në këto dy fusha. Duke synuar rritjen e kapaciteteve të OJQ-ve - veçanërisht atyre në nivel lokal - në mënyrë që të jenë më aktive dhe të kontribuojnë në procesin e pajtimit në Kosovë, ekipi i YHR KS organizoi këtë trajnim të avancuar tre ditor që u udhëhoq nga Nora Ahmetaj si eksperte në drejtësinë tranzicionale. Në mesin e shumë temave të trajtuara ishin drejtësia tranzicionale, dialogu ndërkulturor, procesi i ballafaqimit me të kaluarën, mbledhja e fondeve për drejtësinë tranzicionale dhe projektet e pajtimit. Agjenda e trajnimit përfshiu tre folës të ftuar për një orë ose më shumë çdo ditë, sikur: Besnik Beqa nga HLC, Mehmet Musaj nga QKRMT dhe përfaqësues të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Sesione informuese ‘Parimet mbi Ballafaqimin me të Kaluarën’

Të rinjtë/rejat nga shkollat e mesme dhe universitetet e Istogut, Pejës, Shtërpçës, dhe Prizrenit tani janë më të informuar rreth *Parimeve mbi Ballafaqimin me të Kaluarën* në kontekstin e Kosovës. Në sesionet informuese interaktive të zhvilluara nga ekspertja e drejtësisë tranzicionale, Nora Ahmetaj, studentët/et patën mundësinë të mësojnë dhe të diskutojnë më shumë për procesin e ballafaqimit me të kaluarën, dhe konkretisht për këtë iniciativë qytetare e cila synon të drejtojë akterët politikë dhe publik, mediat si dhe të rinjtë/rejat se si të trajtojnë temat që lidhen me të kaluarën. *Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën* është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo-formal i përbërë nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS), Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (HLCK), Integra, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), Qendra e Rehabilitimit e Kosovës për Viktimat e Torturës (KRCT), dhe Nora Ahmetaj.

Konferenca: “Përkujtimet e luftërave të viteve 1990 gjatë vitit 2021”

YIHR KS, YIHR Serbia, YIHR BiH dhe YIHR MN prezantuan gjetjet e raportit rajonal dhe manualit mbi përkujtimet e krimeve të luftës dhe të luftës në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Mal të Zi për periudhën janar - tetor 2021.

Këto dy botime janë rezultat i monitorimit të praktikave përkujtimore të organizuara nga institucionet shtetërore, shoqatat e viktimave dhe organizatat e shoqërisë civile që iu kanë kushtuar konflikteve të viteve 1990.



PROGRAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E LIGJIT

09



PROGRAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E LIGJIT

PROJEKTI

“Fuqizimi i të Rinjve duke rritur Edukimin Mbi Sundimin e Ligjit dhe të Drejtat e Njeriut në shkolla”

Ky projekt synon fuqizimin e të rinjve/rejave që të bëhen pjesëmarrës/e aktivë/e në jetën qytetare në Kosovë, duke rritur njohuritë, të menduarit kritik dhe aftësitë e tyre për të kërkuar drejtësi. Baza e projektit është Manuali për Edukimin për të Drejtat e Njeriut për të Rinj/Reja, i cili është krijuar nga YIHR KS dhe i akredituar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit (MASHTI) dhe Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM). Objektivi i dytë i projektit është rritja e kapaciteteve të mësuesve të shkollave fillore përmes kurseve të trajnimit për të ofruar programin e edukimit për të drejtat e njeriut në klasat e tyre.

Memorandume të Bashkëpunimit

Në kuadër të projektit, ne mbajmë një kurs trajnimi me studentë/e të Drejtësisë për të folurit publik dhe ligjërimin mbi të drejtat e njeriut, sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit, bazuar në Manualin për Edukimin për të Drejtat e Njeriut për të Rinj/Reja. Më pas, studentët/et do të kenë mundësinë t'u ligjërojnë nxënësve/eve të shkollave fillore nga pesë komunat e targetuara. Për të lehtësuar koordinimin dhe bashkëpunimin efektiv, kemi nënshkruar Memorandume Bashkëpunimi me Drejtoritë e Arsimit të Komunave të synuara, të cilat do të na ndihmojnë të koordinojmë më mirë aktivitetet tona dhe të ndihmojnë me aktivitetin tjetër të parashikuar në projekt, që është kursi i trajnimit me profesorët e edukatës qytetare nga komunat e parapara në manual. Pas kursit të trajnimit, profesorët do t'ua prezantojnë manualin studentëve/eve të tyre dhe do ta përfshijnë atë në kurrikulat e tyre.

Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për të drejtat e njeriut dhe rritja e edukimit për të drejtat e njeriut

Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për të drejtat e njeriut dhe rritja e edukimit për të drejtat e njeriut është një projekt i krijuar me qëllim të bashkimit të organizatave të shoqërisë civile dhe aktivistëve/eve të tjerë/a dhe përmes ngritjes së kapaciteteve të tyre, të promovojë dhe avokojë për të drejtat e njeriut për të gjithë dhe të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënien e institucioneve shtetërore.

Punëtori me partnerët e Rrjetit të të Drejtave të Njeriut

Përfaqësuesit/et e Komitetit Koordinues të Rrjetit të të Drejtave të Njeriut morën pjesë në një punëtori dy ditore me qëllim të përcaktimit të kornizës për Raportin e katërt të Përbashkët të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut, i cili do të publikohet në vitin 2023. Gjatë takimit ata diskutuan çështjet më urgjente në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe folën për avokimin dhe aktivizmin si mekanizëm për të kontribuar në nxitjen e dialogut ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OShC-ve.



Punëtori për ngritjen e kapaciteteve të OShC-ve

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të organizatave lokale dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile, YIHR KS organizoi tri punëtori për ngritjen e kapaciteteve në Prishtinë në vitin 2022. Gjatë punëtorive përfaqësuesit/et e organizatave patën mundësinë të mësojnë më shumë për të drejtat e njeriut në përgjithësi, institucionet e drejtësisë dhe për të rritur kapacitetet e tyre për metodologjitë e raportimit. Gjatë punëtorive u trajtuan disa tema specifike si të drejtat e komunitetit LGBTQIA+.



Takimi konsultativ i organizatave për raportin e përbashkët të OShC-ve

Publikimi i Raportit vjetor të OShC-ve për të Drejtat e Njeriut është një vlerësim i cili publikohet çdo vit nga Rrjeti për të Drejtat e Njeriut. Me qëllim të grumbullimit të të dhënave nga organizatat e shoqërisë civile, YIHR KS organizoi tre

takime konsultative në vitin 2022 për të diskutuar strukturën dhe përmbajtjen e raportit të tretë dhe të katërt dhe për të identifikuar fushat më kritike për t'u trajtuar.

Living Libraries / 'Bibliotekat e Gjalla'

Në vitin 2022 YIHR KS organizoi dy biblioteka të gjalla në Shtime dhe Han të Elezit. Ideja e aktivitetit ishte nxitja e mendimit kritik tek nxënësit e shkollave të mesme për çështje të rëndësishme siç janë të drejtat e njeriut në Kosovë dhe të drejtat e grupeve më të cenueshme në Kosovë, duke përfshirë gratë, komunitetin LGBTQIA+, komunitetet joshumicë në Kosovë si dhe personat me aftësi të kufizuara. Në aktivitetet tona të bibliotekës së gjallë patëm një numër aktivistësh dhe të rinjsh që ndanë historitë dhe përvojat e tyre personale për audiencën.

Zhvillimi i metodologjisë për vlerësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë

Në vitin 2022 YIHR KS zhvilloi metodologjinë me indikatorë për vlerësimin e situatës së të drejtave të njeriut si dhe metodologjinë për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet vjetore për të drejtat e njeriut. Dokumentet do të shërbejnë për të unifikuar procedurën e raportimit për të gjitha organizatat kontribuese në raport si dhe për të ngritur kapacitetet e tyre profesionale raportuese në fushën e të drejtave të njeriut.



Publikimi i Raportit të tretë vjetor të përbashkët të OS-hC-ve për të Drejtat e Njeriut për vitin 2021

Në maj 2022, u publikua Raporti i tretë vjetor i përbashkët i OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut për vitin 2021. Për këtë u organizua një event që mbledhi përfaqësuesit/et e organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe institucioneve në një diskutim mjaft të frytshëm në Prishtinë. Gjatë aktivitetit u prezantua raporti dhe rekomandimet iu drejtuan institucioneve shtetërore kompetente.

PROJEKTI

Gjuha kundër urrejtjes në Ballkanin Perëndimor

Gjuha kundër urrejtjes në Ballkanin Perëndimor është një projekt regjional që trajton gjuhën e urrejtjes në media ndaj grupeve më të marginalizuara. Ideja kryesore e këtij projekti është monitorimi dhe regjistrimi i gjuhës së urrejtjes në Ballkanin Perëndimor si dhe rritja e njohurive për identifikimin dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes përmes avokimit publik dhe rrjedhës së informacionit.

Identifikimi i rasteve të gjuhës së urrejtjes

Nga janari deri në dhjetor 2022 YIHR KS ka regjistruar rastet më të dukshme të gjuhës së urrejtjes ndaj grupeve të marginalizuara në Kosovë. Të gjitha rastet e gjuhës së urrejtjes që kemi monitoruar kanë qenë ndaj komunitetit LGBTQIA+, grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Kosovë. Janë identifikuar gjithsej 25 raste të gjuhës së urrejtjes në media. Është shumë e rëndësishme të përmendet se numri mund të jetë më i lartë për shkak të pluralizmit të mediave në Kosovë dhe mungesës së kontrollit të autoritetit kur bëhet fjalë për mediat e shkruara online. Ky numër rrjedh nga identifikimi i artikujve kryesor që kemi kërkuar për përmbajtje të gjuhës së urrejtjes në mediat e shkruara online dhe nga ajo që YIHR KS ka vëzhguar gjatë gjithë vitit. Nga 25 raste kemi pasur 16 raste të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTQIA+, 4 raste të gjuhës së urrejtjes ndaj grave dhe 5 raste të gjuhës së urrejtjes në baza etnike. Gjithashtu, është një rast i diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar që po gjykohet në gjykatat vendore të Kosovës.

Publikimi i të dhënave statistikore në infografe për rastet e regjistruara të gjuhës së urrejtjes

Në vitin 2022, YIHR KS prodhoi dy infografë informativ mbi situatën e gjuhës së urrejtjes në Kosovë. Infografët kanë pasqyruar statistikën e mbledhura nga YIHR KS. Infografi i parë është publikuar në fund të muajit maj për periudhën kohore nga janari 2022 deri në maj 2022. Pika kryesore e infografit të parë ishte përmbledhja e rasteve të gjuhës së urrejtjes të përhapur gjatë seancës së Kuvendit në të cilën deputetët diskutuan Draft Kodin Civil dhe neni që lejon martesat ndërmjet personave të seksit të njëjtë. Infografi i dytë mbulon periudhën qershor-nëntor 2022. Në këtë infograf vëmendja iu kushtua gjuhës së urrejtjes ndaj gruas, e përdorur shpesh në mediat sociale, e shkaktuar kryesisht nga rritja e raportimit të rasteve të përdhunimeve dhe dhunës në familje në Kosovë.



Koordinim i rregullt me institucione shtetërore

YIHR KS takoi përfaqësuesit e institucioneve publike dhe diskutoi për gjuhën e urrejtjes ndaj grupeve të marginalizuara në Kosovë, veçanërisht komunitetin LGBTQIA+. Komuniteti LGBTQIA+ është përballur me numër të madh të rasteve të gjuhës së urrejtjes gjatë këtij viti kur po diskutohej drafti i Kodit Civil dhe neni për martesat mes personave të të njëjtit seks. Gjatë vitit 2022 YIHR KS u takua me Presidenten e Kosovës, Kryeministrin e Kosovës, Institucionin e Avokatit të Popullit dhe drejtorin e Zyrës për Qeverisje të Mirë. Gjatë takimeve kemi diskutuar situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë në përgjithësi si dhe gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin ndaj grupeve më të marginalizuara. I kemi bërë thirrje institucioneve që të dënojnë gjuhën e urrejtjes ndaj këtyre grupeve dhe të reagojnë publikisht ndaj gjuhës së urrejtjes së përhapur në Kuvendin e Kosovës gjatë seancës kur po diskutohej për Draft Kodin Civil.



Të Rinjtë për Drejtësi

“Të Rinjtë për Drejtësi” synon të fuqizojë të rinjtë/rejat që të kërkojnë drejtësi dhe të bëhen pjesëmarrës/e aktivë/e në sektorin e drejtësisë në Kosovë.

Platforma E Drejta Jem

Gjatë vitit 2022, ekipi i YIHR KS ka vazhduar të promovojë platformën “E drejta jem” në të gjitha aktivitetet. Qëllimi i kësaj platforme është fuqizimi i të rinjve/rejave në sektorin e drejtësisë, ndërgjegjësimi i të rinjve/rejave për llogaridhënien dhe transparencën dhe ngritja e njohurive të tyre për të drejtat e njeriut dhe institucionet e drejtësisë në Kosovë.

Platforma ofron gjithashtu një seksion “Raporto ose Pyet” ku publiku i gjerë mund të raportojë një rast ose të pyesë për një rast në të cilin të drejtat e njeriut janë shkelur. YIHR KS pastaj kërkon llogaridhënie nga institucionet përkatëse dhe i monitoron ato për veprime apo mosveprime lidhur me pyetjet/rastet e raportuara. Gjatë gjithë vitit kemi pranuar **15 raportime** të cilat janë adresuar nga ekipi i YIHR KS tek institucionet përkatëse. Në disa raste YIHR KS ka mundur të krijojë komunikim ndërmjet personave që kanë raportuar dhe institucioneve përkatëse, ndërsa shumë qytetarë/e janë këshilluar që t'i adresojnë problemet e tyre tek autoritetet kompetente dhe për procedurat ligjore që mund të ndërmerren.

Ligjëratat për Drejtësi

YIHR KS organizoi 27 Ligjërata për Drejtësi ku ligjërues/e të trajnuar ligjëruan për studentë/e të shkollave të mesme dhe universiteteve, në të gjitha rajonet e Kosovës. Përmes këtyre sesioneve, pjesëmarrësit/et patën mundësinë të mësojnë më shumë për sistemin ligjor në Kosovë, si dhe të mësojnë më shumë për të drejtat e njeriut dhe institucionet.



Gjykime të Simuluara Lokale

Këtë vit u zhvilluan katër Gjykime të Simuluara në katër qytete të ndryshme. Gjykimet e Simuluara Lokale u ofrojnë nxënësve të shkollave të mesme mundësinë të mësojnë për rolin e gjyqtarëve/eve, prokurorëve/eve dhe avokatëve/eve, si dhe për sistemin ligjor në Kosovë. Në ditën e tretë të këtyre trajnimeve rezidenciale, studentët organizuan një seancë gjyqësore të simuluar, ku ata vetë luajtën rolet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve.



Gara Artistike

Gjatë vitit 2022, është mbajtur një garë artistike për të cilën u ftuan të gjithë të rinjtë/rejat të përdorin aftësitë e tyre kreative për të trajtuar çështjet e të drejtave të njeriut në Kosovë. Mediumet e artit të pranuar në këtë konkurs ishin esetë dhe poezia. Në fund u shpërblyen tre esetë/poezitë më të mira.

Programi i Monitorimit të Seancave Gjyqësore

Ky program është një mundësi e shkëlqyer për të angazhuar studentët/et e drejtësisë drejtpërdrejtë në sistemin juridik. Studentët/et patën mundësinë të shohin seanca të ndryshme gjyqësore dhe të merrnin pjesë vetë në seanca duke monitoruar mbarëvajtjen e gjykimeve dhe duke shkruar raporte mbi funksionimin e sistemit gjyqësor dhe procedurat në gjykata. Këtë vit janë vendosur 50 monitorues/e në gjykata të ndryshme themelore në Kosovë.

Muralet e Drejtësisë

Këtë vit në kuadër të projektit Të Rinjtë për Drejtësi u inauguruan katër Murale të Drejtësisë. Katër shkolla të mesme në Prishtinë, Shtime, Malishevë dhe Pozheran ishin përfituese të këtyre Muraleve të Drejtësisë. Këto murale jo vetëm që zbukurojnë pamjen e shkollës, por edhe rrisin ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut dhe nxisin mendimin kritik te nxënësit.



Programi i Praktikës

Këtë vit dy grupe të praktikantëve u zgjedhën dhe u vendosën në Gjykatat Themelore dhe nën-degët e tyre në rajone të ndryshme të Kosovës. Gjashtëdhjetë (60) studentë/e të juridikut dhe juristë/e të diplomuar/a punuan si praktikantë/e në gjykata ku patën mundësi të punonin me gjykatës/e në departamente të ndryshme.

Dita e Gjykatës së Hapur

Më 25 nëntor, 22 nxënës/e të shkollës së mesme nga rajoni i Gjilanit patën mundësi të vizitojnë Gjykatën Themelore të Gjilanit. Nxënësit/et u takuan me prokurorë/e dhe gjykatës/e, bënë pyetje dhe mësuan për gjykatën, punën dhe funksionin e saj, dhe sistemin e drejtësisë në Kosovë.



Shkolla Alternative për të Drejtat e Njeriut

Shkolla Alternative për të Drejtat e Njeriut u ofroi studentëve/eve, me prejardhje të ndryshme akademike dhe gjeografike ligjërata, biseda dhe vizita gjatë muajit korrik. Pjesëmarrësit/et patën mundësinë të ndjekin ligjërata nga ligjërues/e dhe folës/e të ftuar, dhe të mësojnë për të drejtat e njeriut, si të identifikojnë shkeljet e të drejtave të njeriut, për barazinë gjinore dhe të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Krahas ligjëratave, studentët/et vizituan zyrën e Avokatit të Popullit, Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Kuvendin e Kosovës dhe kanë takuar përfaqësues të OSBE-së.



PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E RINISË

10



PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E RINISË

PROJEKTI

Pajtimi dhe Transformimi i Konfliktit (RCT)

Qëllimi i aktivitetit të Pajtimin dhe Transformimit të Konfliktit (RCT) në Kosovë është të adresojë nevojat aktuale të pajtimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë në nivel individual, komunitar dhe institucional.

Programi i Pajtimin dhe Transformimit të Konfliktit (RCT) zbatohet nga Community Building Mitrovica në partneritet me New Social Initiative dhe Youth Initiative for Human Rights – Kosovë.

25 Takime Bilaterale

Në vitin 2022, gjatë vitit të dytë të projektit, YIHR KS mbajti 25 takime bilaterale. Ekipi i YIHR KS kishte përgatitur një listë të palëve të ndryshme të interesuara për t'u takuar për këtë aktivitet ku morrën pjesë njerëz nga fusha të ndryshme dhe me përkatësi të ndryshme, si gazetarë/e, aktivistë/e (nga komuniteti shqiptar dhe serb në Kosovë), organizata joqeveritare, përfaqësues/e nga Qeveria, pronarë/e të bizneseve, etj. Gjatë këtyre takimeve, ekipi i YIHR KS ka diskutuar me pjesëmarrësit/et për nevojat ekzistuese të pajtimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë në nivel individual, komunitar dhe institucional.



Punëtori të Rrethit Koheziv

Punëtorja 1 dhe 2 - Prishtinë

Në prill, ekipi i YIHR KS organizoi punëtorinë e parë me anëtarët e rrethit të kohezionit në Prishtinë. Punëtorja tre-orëshe mbledhi 20 pjesëmarrës/e. Qëllimi i punëtorive ishte që anëtarët/et të takoheshin reciprokisht me njëri-tjetrin dhe të përcaktojnë një vend për ngjarjet e komunitetit.

Punëtorja e dytë u mbajt në maj, në Prishtinë. Qëllimi i seminarit ishte që t'u mundësojë anëtarëve/eve të reflektojnë dhe shtjellojnë ide të mëparshme dhe të propozojnë tema shtesë dhe veprime të mundshme. Takimi mbledhi 8 pjesëmarrës/e nga rajoni i Prishtinës të cilët diskutuan për planifikimin e ngjarjeve në komunitet.

Punëtorja 3 dhe 4 - Gjilan

Në shtator, ekipi i YIHR KS mbajti punëtorinë e 3-të të Rrethit Koheziv në Gjilan, gjatë së cilës u diskutua më në detaje rreth planifikimit të aktiviteteve.

Punëtorja e katërt “Ushqimi jonë tradicional” u mbajt në qytetin e Gjilanit në muajin nëntor. Në këtë event ishin të pranishëm 31 pjesëmarrës/e. Ideja e këtij aktiviteti ishte që pjesëmarrësit filimisht të njiheshin me ushqimin dhe muzikën tradicionale, më pas të vizitonin Muzeun e Qytetit.



Përpilimi dhe rishikimi i kurrikulave/programeve të arsimit joformal

YIHR KS filloi përpilimin e një manuali për të mësuarit ndërkulturor në nivel lokal, duke përdorur histori suksesi si shembull në shkurt të vitit 2022.

Manuali mbi Edukimin Qytetar për Paqe është i mbushur me një sërë aktiviteteve dhe metodash të edukimit joformal për të promovuar mësimin ndërkulturor dhe për të adresuar nevojat e komunitetit për t'u ballafaquar me të kaluarën, pajtimin dhe transformimin e konflikteve.

Manuali i Edukimit Qytetar për Paqe është krijuar si një burim i vlefshëm për edukatorët/et dhe liderët/et e të rinjve/rejave për të promovuar mësimin ndërkulturor dhe për të nxitur një kuptim më të thellë të ballafaqimit me të kaluarën, pajtimin dhe transformimin e konflikteve. Ai synon të shërbejë si një udhëzues për mësuesit/et, grupet e të rinjve/rejave dhe anëtarët/et e tjerë/a të komunitetit.

'Bibliotekat e Gjalla' - Punëtori të tregimit

Punëtoritë e tregimit synojnë të angazhojnë dhe ndihmojnë të rinjtë/rejat në shprehjen e vizionit të tyre. Janë mbajtur tri punëtori të tregimit në tre qytete të ndryshme: Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan. Në këto punëtori, të rinjtë/rejat nga komunitetet e ndryshme në Kosovë patën mundësinë të mësojnë se si të përdorin forma të ndryshme të artit si shkrimi, dizajni dhe muzika për të trajtuar temat e ballafaqimit me të kaluarën. Për më tepër, ata patën mundësinë të dëgjojnë nga aktivistë/e për historitë e tyre, gjë që i ndihmoi ata/ato të kuptojnë përvojat e njëri-tjetrit, të thyejnë barrierat dhe të diskutojnë zgjidhjet për të përmirësuar më tej marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në Kosovë.

Kampi Rinor i Paqes

Kampi Rinor i Paqes u mbajtë në gusht me 23 të rinj/reja nga komunitete të ndryshme në rajonin e Gjilanit. Kampi u fokusua në tema që lidhen me paqen, mësimin ndërkulturor dhe pajtimin, dhe theksoi punën ekipore, komunikimin paqësor dhe bashkëpunimin. Pjesëmarrësit/et nga grupe të ndryshme etnike, prezantuan ide për qytetari aktive dhe aktivizëm të përgjegjshëm shoqëror. Një nga idetë rezultoi në një aksion rrugor për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Rinisë me sloganin "Na jena këtu, ndëgjone zanin tonë".



Nxitja e Qasjeve të Reja për Pajtimin e të Rinjve/Rejave

Qëllimi i projektit Nxitja e Qasjeve të Reja për Pajtimin e të Rinjve/Rejave është të përmirësojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërkulturor ndërmjet të rinjve/rejave me përkatësi të ndryshme etnike si dhe të sfidojë diskursin publik të njëanshëm dhe etno-nacionalist lidhur me të kaluarën e Kosovës dhe duke e pasuruar atë me histori dhe përvoja personale të njerëzve.

Krijimi i bashkëpunimit me organizatat lokale

Këtë vit YIHR KS ka bashkëpunuar në promovimin e dialogut ndërkulturor, që ka të bëjë me drejtësinë tranzicionale dhe fuqizimin e të rinjve/rejave me 4 organizata si Centar Manjinske Zajednice (CMZ) në Graçanicë, Lokalni Omladinski Savet, në Shtërpçë, Social Knowledge for Real Accountability and Transparency (SOKRAT) në Partesh dhe Local Peace në Leposaviq.

Punëtori e Storytelling “Youth Remembers Initiative”

Në vitin 2022 YIHR KS organizoi dy Punëtori të Storytelling. Gjatë këtyre punëtorive, 42 të rinj/reja nga komunitete të ndryshme etnike mësuan për rëndësinë e dokumentimit të përvojave të luftës. Ata gjithashtu mësuan për teknikat e tregimit dhe përfitimet e përdorimit të këtyre formave kreative të të shprehurit në proceset e ballafaqimit me të kaluarën.

Programi i Praktikës për të rinj/reja nga komunitetet jo-shumicë

Këtë vit Alisan Skenderi iu bashkua YIHR KS në rolin e praktikantit. Ky program praktike u krijua si një mundësi për të mësuar më shumë për kujtesën kolektive, funksionimin e OShC-ve, për të mbështetur organizatën me punë të ndryshme ditore dhe në përgjithësi për të rritur kapacitetet në fusha që janë me interes për praktikantët/et.



JAVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

11



JAVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

YIHR KS shënoi një edicion të jashtëzakonshëm të Javës të së Drejtave të Njeriut Vol.9. me sloganin “Të bashkuar, kundër padrejtësive!” Gjatë kësaj jave u fokusuam në lidhjen midis të drejtave të njeriut dhe ndërtimit të paqes. Përmes 12 aktiviteteve të ndryshme, nga më formale deri tek ato më kreative, diskutuam, analizuam dhe menduam në mënyrë kritike për përmirësimet e nevojshme në fushën e paqes dhe të drejtave të njeriut. Njëkohësisht, ne theksuam mënyrat në të cilat ndërtimi i paqes dhe shmangia e konflikteve lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në grupet e marginalizuara.

CALENDAR OF ACTIVITIES

10:00-12:00 Conference: State Obligations Towards Human Rights
National Library

18:00-22:00 Activism Hub Launching & Winner Announcement for the Human Rights Activist of the Year Prize
Offices of YIHR KS

14:00 - 15:30 Discussion: The Ripple Effects of War
Offices of YIHR KS

18:00 - 20:00 Exhibition: Virtual Museum of Refugees
National Museum of Kosovo

20:10 TV Debate: Hate Speech & Discrimination
DESKU, KTV

12:00 - 16:00 Activism Workshop
Human Rights Activism Hub at YIHR KS Offices

18:00 Rights Land Podcast
YouTube: YIHR KS Channel

20:00 - 22:00 Trivia Night in PJs
Offices of YIHR KS

14:00 Street Action: 'Answer the Call, Don't Pass the Ball'
Skenderbeu Square
Awareness-Raising Video
YIHR KS Facebook

20:30 Theatre Play: Inside Four Walls & Drag Show
Oda Theatre

ORGANISER:



DONORS:




Konferencë “Obligimet e Shtetit Ndaj të Drejtave të Njeriut”




Hapja e Hapësirës për Aktivizëm dhe Ndarja e Çmimit Aktivisti/ja i/e Vitit për të Drejta të Njeriut



Bisedë: “Efektet Zinxhirore të Luftës”



Ekspozitë: Muzeu Virtual i Refugjatëve



Punëtori për Aktivizëm- Hapësira për Aktivizëm në Zyrën e YIHR KS



Debat Televiziv: Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes në Kosovë




<https://bit.ly/3VXReDH>

Video Sensibilizuese: 'Çele Telefonin, Mos e Gjuj Topin!'

<https://fb.watch/j5GpcD9RnR/?mibextid=qC1gEa>



Rights Land Podcast




Rights Land Podcast - Episode 1


2 views • Dec 9, 2022

0 DISLIKE SHARE CLIP SAVE ...

<https://bit.ly/3Jy0VW1>



Aksion Rrugor: “Çele telefonin, mos e gjuj topin”



Shfaqje Teatrale: “Mrena Katër Mureve” dhe Drag Show



PROTESTAT

12



Protesta kundër Homofobisë para Kuvendit për neglizhencën dhe refuzimin për avancimin e të drejtave të njeriut

YIHR KS protestoi para Kuvendit për të shprehur pakënaqësinë për neglizhencën dhe refuzimin e avancimit të të drejtave të njeriut, për të gjithë personat pa dallim, të cilat janë të garantuara me Kushtetutë! Me moton 'DEPUTETËT BETOHEN NË KUSHTETUTË, JO PËR LIBRA FETARË!' Protestuam para Kuvendit me mesazhin se kjo betejë nuk ka përfunduar ende, do të rezistojmë deri në arritjen e barazisë sociale.

Protesta kundër luftës në Ukrainë

YIHR KS së bashku me qytetarët/et e Kosovës para Zyrës Ndërlidhëse Ruse në Prishtinë, protestuan duke u shprehur se shoqëria dhe shteti ynë qëndrojnë kundër okupimit të Ukrainës nga Federata Ruse.

Si shoqëri, ne kemi përjetuar efektet shkatërruese të luftës, pasojat e së cilës vazhdojmë t'i vuajmë edhe sot, prandaj ne bashkëndejmë me popullin e Ukrainës për vuajtjet e tyre në këtë kohë shumë të vështirë.



Marshi kundër vrasjes së grave!

Këtë 8 Mars ne nuk festuam, por marshuam dhe demonstruam rezistencën tonë kundrejt patriarshit.

Duke marshuar nga Pallati i Drejtësisë deri në qendër të Prishtinës, ne ngritëm zërin kundër burrave që vrasin gra dhe i shtruan kërkesat tona institucioneve përgjegjëse për vënien e drejtësisë ndaj vajzave dhe grave që vazhdojnë të vuajnë nga dhuna me bazë gjinore.


Lufta jonë e përbashkët për çlirim, barazi gjinore dhe drejtësi sociale duhet të vazhdojë!

Ky 8 Mars i bëri jehonë solidaritetit dhe shpresës!

Mbrojte Për Gratë dhe Vajzat!

Pas rastit të përdhunimit të vajzës 11-vjeçare nga 5 djem dhe burra, së bashku me organizatat të tjera dhe grupe të pavarura aktiviste, organizuam protestën me thirrje për 'Mbrojtje për Gratë dhe Vajzat' së bashku me mijëra qytetarë/e. Ne ngritëm zërin dhe i bëmë thirrjet tona më se të qarta:

- 1** Mbrojtje dhe siguri shtetërore për vajzat dhe gratë;
- 2** Trajtimi i drejtë i rasteve të dhunës ndaj grave dhe dënimet meritorë për kryesit;
- 3** Legalizimi i përdorimit dhe shpërndarjes së gazit irritues për vetëmbrojtje (pepper spray).



Protestë Para Këshillit Prokurorial të Kosovës

Protesta jonë e parë kundër përdhunimit të një vajze 11-vjeçare nga 5 djem dhe burra na solli informacione të reja që dyfishojnë fajin e shtetit në këtë krim. U arrestuan edhe 6 burra të tjerë, të cilët në muajin qershor kishin trafikuar, përdhunuar dhe shfrytëzuar të miturën për shërbime seksuale. Pavarësisht kësaj, Prokuroria e Shtetit nuk ka marrë përgjegjësi, edhe pse nuk arriti ta mbrojë viktimën dhe ta parandalojë dhunimin e saj në gusht. Në këto kushte, protesta jonë e dytë nuk u ndal tek Qeveria. Vazhdoi në Këshillin Prokurorial të Kosovës, ku kërkuam shkarkimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi.

Protestë Simbolike Para Këshillit Prokurorial të Kosovës

E mbyllëm me dy shirita hyrjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës duke kërkuar nga KPK-ja shkarkimin e prokurorit Ruhan Salihu dhe kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi. Ne shpallëm Prokurorinë dhe KPK-në si zona krimi. Nëpërmjet këtyre institucioneve mbahen dhe riprodhohen prokurorë neglizhentë, seksistë dhe racistë, të cilët më pas bëhen bashkëfajtorë në krime me bazë gjinore.



Gru, Jetë, Liri!- Në solidaritet me gratë në Iran

Policia e moralit në Teheran të Iranit vrau Mahsa Amini, 22 vjeç, sepse nuk e kishte mbajtur siç duhet shaminë. Pas kësaj ngjarje, protestat u përhapën në të gjithë vendin. Shumë gra në Iran po heqin mbulesën dhe po presin flokët në shenjë proteste dhe rezistence kundër kontrollit në bazë gjinore dhe dhunës ndaj tyre. Që nga fillimi i protestave më shumë vajza dhe gra protestuese janë zhdukur dhe janë gjetur të vdekura.

Për këto shkelje të të drejtave të njeriut, vende dhe komunitete të ndryshme në mbarë botën po protestojnë. Në shenjë solidariteti me gratë dhe vajzat në Iran, ne si Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e pamë si jetike të bëjmë të ditur se edhe Kosova qëndron pas kësaj kauze.

Ne qëndruam në solidaritet me gratë në Iran dhe u ndjemë tejet mirë dhe të frymëzuar nga pjesëmarrja e të gjithëve, duke u bashkuar në protestë, ashtu edhe duke i prerë flokët në shenjë solidariteti.



AKSIONET RRUGORE

13



Parimet e Ballafaqimit me të Kaluarën - Aksionet Rrugore

Në rrugët e qytetit të Mitrovicës, Pejës dhe Gjakovës organizuam aksione rrugore ku treguam parimet e Ballafaqimit me të Kaluarën përmes një instalacioni.

Duke qenë të vetëdijshëm për ndikimin e dëmshëm dhe negativ të deklaratave dhe veprimeve të njëanshme ose të rreme mbi viktimat dhe të mbijetuarit e luftës, gjuhën e urrejtjes, narrativat e dëmshme, glorifikimi i njerëzve të dënuar për krime lufte, mohimi i krimeve dhe rrëfimet e njëanshme nga akterët shtetërorë dhe veprime të tilla në procesin e ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë, u bëjmë thirrje politikanëve, akterëve të tjerë shtetërorë dhe publikut të gjerë që të informohen mbi Parimet e Ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë, se si duhet trajtuar viktimat, të mbijetuarit, tregimet historike dhe të kaluarën e dhimbshme për t'u ofruar atyre respektin dhe drejtësinë që meritojnë.

Qytetarët/et shprehën interesim për këto parime duke i lexuar dhe duke hulumtuar më shumë për to.

Ky aksion rrugor u organizua nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosova (YIHR KS), si pjesë e Koalicionit Joformal për Parimet e Ballafaqimit me të Kaluarën.

Dita e Kushtetutës - Aksion Rrugor

Më 9 prill, përmes aksionit rrugor “A pe dini që po na shkelin Kushtetutën?” kërkuam llogaridhënje nga institucionet shtetërore për shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Ky koncept erdhi si rezultat i mos kalimit të draft kodit civil që lejon martesën mes personave të seksit të njëjtë në Kuvendin e Kosovës.



Dita Kombëtare e Personave të Pagjetur- Aksion Rrugor

Më 27 prill 2022, YIHR KS shënoi Ditën Kombëtare të Personave të Pagjetur përmes një aksioni rrugor në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë. Së bashku me aktivistë/e dhe qytetarë/e vendosëm në tokë lule në formën e numrit 1620 si simbol për 1620 persona të pagjetur. Përmes këtij aksioni në rrugë, ne u solidarizuam me dhimbjen e të gjitha familjeve të personave të pagjetur dhe njëkohësisht kërkuam përgjegjësi dhe veprim institucional për zbardhjen e fatit të të gjithë të pagjeturëve.



Dita Ndërkombëtare e Refugjatëve - Aksion Rrugor

Më 20 qershor 2022, ne shënuam Ditën Ndërkombëtare të Refugjatëve përmes aksionit rrugor “Unë isha refugjat”. Një numër i madh i qytetarëve/eve dhe aktivistëve/eve kontribuan në aksion duke nënshkruar instalimin për të treguar se ata ishin refugjatë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Në të njëjtën kohë, ata shprehën solidaritetin dhe mbështetjen e tyre ndaj të gjithë personave që janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të kërcënimit të jetës, sigurisë apo lirisë së tyre.



Dita Ndërkombëtare e të Rinjve/Rejave - Aksion Rrugor

Më 12 gusht, YIHR KS përmes aksionit rrugor “Kur bohët mirë?!” shënoi Ditën e Rinisë. Të rinjtë dita-ditës janë gati të largohen nga Kosova, për shkak të shkeljeve themelore të të drejtave të njeriut. Migrimi i të rinjve/rejave kosovarë/e është një shqetësim i madh dhe duke ekspozuar valixhe në sheshin kryesor në Prishtinë, ne u përpoqëm të portretizojmë se sa real është ky problem dhe përmes bashkëbisedimit me qytetarët/et kemi reflektuar për situatën në Kosovë.



“Na jena këtu, ndëgjone zanin tonë” - Aksion Rrugor

Më 12 gusht shënuam Ditën Ndërkombëtare të Rinjve/Rejave në Gjilan përmes aksionit rrugor “Na jena këtu, ndëgjone zanin tonë”. Qytetarët/et dhe aktivistët/et iu bashkuan aksionit duke shkruar mesazhe pozitive dhe negative në “Murin e Rinisë” për realitetin me të cilin rinia e Kosovës po vazhdon të përballlet. Duhet të dëgjohen përvojat e ndryshme të të rinjve/rejave dhe institucionet duhet të bëjnë një përpjekje serioze për të përfshirë dëshirat dhe nevojat e të rinjve/rejave në politikëbërjen e tyre.



‘Dera e Pritjes’ - Aksion Rrugor

Ditën Ndërkombëtare të Zhdukjeve të Dhunshme, 30 gushtin, e shënuam duke u solidarizuar me dhimbjen dhe revoltën e familjeve dhe shoqërisë për zbardhjen e së vërtetës dhe gjetjen e drejtësisë për 1621 persona të zhdukur dhunshëm. Në këtë aksion rrugor, në sheshin kryesor të Prishtinës u vendos një ‘Dera e Pritjes’ për të simbolizuar pritjen tonë të stërzgjatur dhe shqetësimin tonë për moszgjidhjen e kësaj çështjeje prej vitesh. Dera ishte e mbuluar me ngjyrë të zezë për të portretizuar agoninë që ndjejnë familjet që presin ndriçimin e fatit të personave të pagjetur.



Dita Ndërkombëtare e Paqes - Aksion Rrugor

Ditën Ndërkombëtare të Paqes e shënuam me aksion rrugor në sheshin Zahir Pajaziti. Këtë vit, Ditën e Paqes ia kushtuam Gjeneratës së Paqes si një mënyrë për të njohur përpjekjet, kontributin dhe ndikimin e të rinjve/rejave në ndryshimet shoqërore. Së bashku festuam brezin tonë të ri që punon në mënyrë aktive dhe të palodhur për të zhbërë padrejtësitë dhe për të ndërtuar paqen njëherë e përgjithmonë. Kjo ditë shërbeu si një mundësi e mirë për të reflektuar mbi atë që kemi bërë deri më tani dhe çfarë mund të bëjmë më tej për ndërtimin e paqes.



AKTIVITETET SHITESË

14




Java e Krenarisë

Si pjesë e grupit punues të Javës së Krenarisë, YIHR KS mbështeti Javën e Krenarisë (6 qershor - 9 qershor) këtë vit duke bashkëorganizuar aktivitete të shumta së bashku me CEL dhe CSGD. Java e Krenarisë këtë vit synoi të nxjerrë në dritë çështjen e draft Kodit Civil dhe martesës mes personave të seksit të njëjtë. Përmes sloganit “Edhe n’Shtet, edhe n’Familje” YIHR KS bëri thirrje për solidaritet, barazi, drejtësi dhe ndryshime sociale. Më 9 qershor, Parada e 6-të e Krenarisë u mbajt me një marshim në rrugët e Prishtinës. YIHR KS qëndron në solidaritet dhe vazhdon të mbështesë, avokojë dhe rezistojë së bashku me miqtë tanë queer në luftën për liri, pranim dhe barazi si në shtet ashtu edhe në familje. Ne do të festojmë prezencën dhe kontributin e komunitetit LGBTQIA+ dhe ngjyrat që ata sjellin në këtë botë!

YIHR KS avokoi për Rregullimin e Martesave mes personave të seksit të njëjtë në Kodin Civil

Më 20 janar 2022, mbi 60 organizata të shoqërisë civile dhe aktivistë/e iu bashkuan proceseve të raporteve avokuese për rregullimin e martesave ndërmjet personave të të njëjtit seks në Projekt Kodin Civil.



DONATORËT



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



UNITED NATIONS
HUMAN RIGHTS
OFFICE OF THE HIGH COMMISSIONER



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe





YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA